



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E POLITIKAVE EKONOMIKE DHE PROMOVIMIT TË BASHKISË

Nr 2418 prot

Roskovec më 26 03 2024

SHPALLJE

**Pozicioni** : Ekspert për hartimin e planit të mbarshimit për ekonominë pyjore të bashkisë.

Plani i mbarshimit për ekonominë pyjore të Bashkisë Roskovec synon të zhvillojë një qasje gjithëpërfshirëse për menaxhimin e sipërfaqeve pyjore, duke siguruar një administrim të qëndrueshëm të këtyre resurseve. Ky menaxhim merr parasysh aspektet ekologjike, duke garantuar një strukturë dhe cilësi të përshtatshme në harmoni me kushtet natyrore dhe objektivat e mbarshimit.

Ky plan është një dokument bazë për menaxhimin e pyjeve, i cili duhet hartuar sipas njësive të ekonomisë pyjore, me punime në terren dhe në zyrë me qëllim njohjen dhe mbledhjen e të dhënave mbi tokën, klimën, faunën, biodiversitetin, grumbullin pyjor, si dhe përcaktimin e masave për administrimin dhe qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor. Plani përfshin gjithashtu organizimin e prodhimit dhe planifikimin e punimeve të ndërthurura silvikulturore.

Plani i menaxhimit do të përfshijë pyjet (pyjet e larta, cungishtet, shkurret) dhe kullotat që ndodhen brenda kufijve administrativë të Bashkisë. Për këtë arsye, dokumenti do të emërtohet "Plani i Mbarshimit për ekonominë Pyjore".

Ky plan ka disa objektiva specifike:

1. **Përdorimi i territorit** – Të përcaktohet përdorimi i territorit në përputhje me gjendjen aktuale dhe nevojat lokale.
2. **Qeverisja e sektorit** – Të optimizohet modeli i qeverisjes, duke u përshtatur me nevojat e komunitetit, karakteristikat e fondit pyjor dhe mjedisin, me synim rritjen e prodhimitarisë.
3. **Balancimi i funksioneve** – Të harmonizohen nevojat lokale me mundësitë ekologjike dhe kulturore, duke theksuar rëndësinë multifunksionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve.
4. **Përmirësimi i grumbujve pyjorë** – Të mirëmbahen dhe përmirësohen sipërfaqet pyjore për të siguruar një funksionalitet të qëndrueshëm.
5. **Shfrytëzimi i prodhimitarisë** – Të maksimizohet përdorimi i potencialit prodhues të pyjeve që kanë funksion ekonomik.

6. **Përmirësimi i cilësisë së pyjeve prodhues** – Të rritet cilësia dhe të optimizohet gjendja e grumbujve të trungishtëve me funksion prodhues.
7. **Ripërtëritja natyrore** – Të inkurajohet dhe përdoret sa më shumë ripërtëritja natyrore për krijimin e ekosistemeve pyjore të qëndrueshme dhe të përshtatshme për mjedisin.
8. **Mbrojtja fitosanitare** – Të reduktohen ndikimet negative në gjendjen shëndetësore të pyjeve.
9. **Reduktimi i prerjeve të paligjshme** – Të merren masa për të minimizuar aktivitetet e paligjshme në pyje.
10. **Rehabilitimi dhe rritja e qëndrueshmërisë** – Të rehabilitohen sipërfaqet pyjore dhe kullimore, duke siguruar një rritje të qëndrueshme të prodhimtarisë.
11. **Pjesëmarrja e komunitetit** – Të promovohet angazhimi i gjerë i popullsisë lokale në procesin e vendimmarrjes për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave.
12. **Menaxhimi i integruar** – Të zhvillohet një model menaxhimi që lidh në mënyrë efektive

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

#### Plani I Mbarështimit për ekonominë pyjore synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

1. **Përgatitjen e një plani shumëfunksional**, duke mbuluar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike.
2. **Njohjen e burimeve lokale**, duke përfshirë:
  - Sipërfaqet pyjore dhe jopyjore;
  - Produktet drusore dhe jodrusore;
  - Kullotat dhe produktet e tyre;
  - Gjendjen e turizmit dhe infrastrukturën didaktike dhe të kërkimit shkencor.
3. **Identifikimin e problemeve lokale**, si:
  - Erozioni,
  - Rrëshqitjet,
  - Zjarret në pyje,
  - Prerjet ilegale,
  - Mbikullotja, etj.
4. **Përgatitjen dhe pjesëmarrjen aktive** në të gjithë hapat e procesit të hartimit, duke përfshirë aktorët lokalë në planifikimin e tij
5. **Menaxhimin e punës** për hartimin e planit.
6. **Përcaktimin e ndërhyrjeve** për periudhën e vlefshmërisë së planit të mbarështimit.

### Kualifikimet dhe aftësitë

- Kualifikime dhe licenca të fushës dhe dokumenta të tjera mbështetëse
- Aftësi të mira menaxhuese dhe koordinuese

### Përvojë e Përgjithshme e Punës

1. Të ketë përvojë të mëparshme në hartimin e planit të mbarështimit
2. Të ketë njohuri të thelluara në fushën pyjore

## **Procedura e aplikimit**

Aplikantët duhet të dorëzojnë një letër motivuese, një CV dhe kualifikime apo lishenca të kësaj fushe. Mund të përfshihet çdo dokument shtesë përkatës. Aplikimet duhet të dorëzohen në adresën e e-mailit : [enerida.kuqo@bashkiaroskovec.gov.al](mailto:enerida.kuqo@bashkiaroskovec.gov.al) ose prane zyres se protokollit,bashkia Roskovec.

Në subjektin e e-mail-it duhet të shkruhet: Aplikim për Ekspert për hartimin e planit të mbarshtimit mbarshtimit për ekonominë pyjore të bashkisë

**KRYETAR**  
**Majlinda Bufi**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZËVENDËSKRYETAR**  
**Maksim Goga**

